REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Bazuar në dispozitat e nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 2 paragrafi 4 dhe nenit 10 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 të datës 28.06.2019 , nenit 2 të Memorandumit të Mirëkuptimit të lidhur në mes të Komunës së Fushë Kosovës, Komunës së Lipjanit, Komunës së Obiliqit, Komunës së Podujevës, Komunës së Prishtinës dhe Qendrës për Mbrojtjen e grave dhe fëmijëve në Prishtinë (QMFG) Nr.1-360/09-15302 të datës 01.04.2026, duke u bazuar edhe në kërkesën e QMFG - së drejtuar Drejtoratit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale me datë 03.07.2026, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 23.09.2026, dhe vazhduar me datë, 08.10.2026 pas shqyrtimit të propozim Vendimit mori këtë:

V E N D I M
PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR QENDRËN PËR MBROJTJEN E GRAVE DHE FËMIJËVE - STREHIMOREN NË MBROJTJE TË VIKTIMAVE TË DHUNËS FAMILJARE DHE ATYRE TË DHUNËS GJINORE

I. MIRATOHET, Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej **3,160.00 €** (tre mijë e njëqind e gjashtëdhjetë euro), për ta mbështetur financiarisht mbulimin e pjesërishëm të shpenzimeve të Strehimores, objekti i së cilës gjendet në Komunën e Prishtinës dhe ju shërben gjashtë Komunave nënshkruese të këtij Memorandumi në mënyrë që strehimorja të kryej funksionin e saj në mbrojtje të viktimave të dhunës familjare dhe atyre të dhunës gjinore.

II. Ndarja e mjeteve të cekura në pikën I të këtij Vendimi bëhet konform dispozitave të Memorandumit të Mirëkuptimit të lidhur në mes të Komunës së Fushë Kosovës, Komunës së Lipjanit, Komunës së Obiliqit, Komunës së Podujevës, Komunës së Prishtinës" dhe Qendrës për Mbrojtjen e grave dhe fëmijëve në Prishtinë si dhe kërkesës së QMGF dërguar Drejtoratit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale të datës 03.07.2026 në të cilën përcaktohet obligimi i komunave të cekura për mbulimin e pjesërishëm të shpenzimeve të strehimores për periudhë tre (3) vjeqare 2026, 2027 dhe 2028 dhe konkretisht kontributi financiar i Komunës së Lipjanit i kalkuluar për vitin 2026 për strehimoren do të jetë **3,160.00 €** (tre mijë e njëqind e gjashtëdhjetë euro).

III. Shuma e mjeteve të cekura në pikën **I** të këtij Vendimi do të ndahen nga të hyrat vetanake të Komunës, kategoria ekonomike - subvencione dhe transfere të planifikuara

për Zyrën e Kryetarit të Komunës për vitin 2026, programi – 16003, fondi burimor: 21/613/16003/200/00000/0111.

IV. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

V. Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës

Nr. 15-400/01-51320
Lipjan, më 08.10.2026

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit
Daut Azemi

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E LIPJANIT
KUVENDI I KOMUNËS
XV
SKUPŠTINA OPŠTINE
OPŠTINA LIPLJAN
REPUBLIKA KOSOVA